



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES  
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS**

Nr. 1158 Prot.

Vau Dejes me 20.02.2023

**NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18 pika 1 dhe pika 2 , neni 54 germa (e) dhe në Rregulloren e Brendshme për Funkcionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës (VKB 23/2020) neni 154:

Këshilli Bashkiak Vau Dejës fton të gjithë banorët e fshatit Mjedë (të pajisur me dokument identifikimi), Njesia Administrative Vau Dejes të bëjnë sugjerimet e tyre lidhur me projekt vendimet e mëposhtëme:

**Projekt vendim për dhënien me qira për veprimtari bujqësore, të sipërfaqes prej 3.124 ha, pjesë e pasurisë nr.133/6, Zk nr 2702, e llojit “Ullishte”, ndodhur në fshatin Mjedë, Njesia Administrative Vau Dejes, Bashkia Vau Dejes.**

(Paraqitur nga Drejtoria e Prokurimeve dhe Integritetit Sektori Aseteve.)

Dëgjesa publike do të bëhet me datë **20.03.2023 ora 11.00** fshati Mjedë, Njesia Administrative Vau Dejes.

Gjithashtu ju ftojme të bëheni pjesë e dëgjësës për projekt vendimin e mësipërm, nëpërmjet sugjerimeve tuaja në adresat elektronike:

([info@vaudejes.gov.al](mailto:info@vaudejes.gov.al) , [ardian.celepija@vaudejes.gov.al](mailto:ardian.celepija@vaudejes.gov.al), facebook – Këshilli Bashkiak Vau Dejës).

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Ardian ÇELEPIJA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES  
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT  
SEKTORI I ASETETEVE

**PROJEKT VENDIM**

Nr 7. Datë 20.02.2023

**Dhënie pëlqimi në parim për dhënien me qira për veprimtari bujqësore, të sipërfaqes prej 3.124 Ha, pjesë e pasurisë nr 133/6, Zk nr 2702, e llojit “Ullishte”, ndodhur në fshatin Mjedë, Bashkia Vau Dejës.**

Bazuar në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 4, të ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr. 8743 datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligji nr 8744, datë 33.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr 1423, datë 10.10.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vau Dejës të Qarkut të Shkodrës”, ligji nr 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr 531, datë 21.08.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, ligji nr 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, Udhëzimi nr 1, datë 18.07.2012. “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, propozojmë që në mbledhjen e radhës, Këshilli Bashkiak të:

**VENDOSI :**

1. Miratimin në parim për dhënien me qira të sipërfaqes prej 3.124 Ha, pjesë e pasurisë nr 133/6, Zk nr 2702, e llojit “Ullishte”, sipas plan rilevimit bashkelidhur, ndodhur në fshatin Mjedë, Bashkia Vau Dejës, e cila mund të përdoret vetem për veprimtari bujqësore, sipas kërkesave të subjekteve të interesuar, dhe plan biznesit të subjektit fitues.
2. Efektet: Jep impakt pozitiv në komunitet duke hapur vende të reja pune, si dhe sigurohen të ardhura për Bashkinë, që kthehen më pas në investime publike.
3. Tarifa e qirasë vjetore dhe afati i dhënies me qira të jetë në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr 1, datë 18.07.2012, “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”.

KRYETARI  
Mark BABANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT  
SEKTORI I ASETVEVE

**RELACION**

DHËNIE NË PËRDORIM TË PASURISË SHTETËRORE E LLOJIT "ULLISHTE" ME SIPËRFAQE PREJ 3.124 HA, NË FSHATIN MJEDË.

**Këshillit Bashkiak Vau Dejës**

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Vau Dejës, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të tjera ka edhe administrimin dhe shfrytëzimin e resurseve të saj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, me qëllim dhënien në përdorim të tretëve, me objektiv për të siguruar të ardhura për bashkinë, që më pas kthehen në investime publike, si dhe duke hapur vende të reja pune me impakt zbutjen e varfërisë dhe për rrjedhojë rritjen e cilësisë së jetës në komunitet.

Mirëadministrimi i Aseteve publike, është një pjesë e rëndësishme e qeverisjes lokale të mire. Me transferimin e pronave të paluajtshme publike shtetërore në administrimin vendor menaxhimi i asetëve publike bëhet një përgjegjësi e rëndësishme vendore në shërbim të shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin e Bashkisë.

Bazuar në ligjin nr 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjin nr 8744 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit, në njesitë e qeverisjes vendore", ndryshuar, Bashkia jep në përdorim subjekteve të interesuar, pasuritë e paluajtshme në pronësi dhe administrim të saj, me kontratë qiraje, sipas procedurave përkatëse të miratuara dhe legjislacionit në fuqi për dhënien në përdorim të tokave bujqësore të pandara.

Bazuar në Udhëzimin nr 1, datë 18.07.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", objekt i këtij udhëzimi janë tokat e regjistruara si të tilla në regjistrat kadastralë dhe që kanë qenë në përbërje të ish kooperativave bujqësore, por që kanë mbetur pa u ndarë sipas ligjit nr 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën". Këto pasuri jepen me qira sipas udhëzimit të mësipërm, vetëm për veprimtari bujqësore, me afate kohore sipas planit të biznesit dhe llojit të veprimtarisë bujqësore që do të ushtrohet nga ana e subjektive të interesuar.

Objekt i qiradhënies së tokës bujqësore është një pjesë e pasurisë nr 133/6, Zk nr 2702, në fshatin Mjedë, me sip 3.124 Ha, e llojit "Ullishte".

Sipërfaqja është e ndarë në 3 miniparcela, që ndahen nga njëra tjetra me rrugë rurale që shërbejnë për kalimin e banorëve, sipas plan rievimit bashkëlidhur.

Për efekt të dhënies me qira konform udhëzimit nr 1, datë 18.07.2012, "Për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara", sipërfaqja në shqyrtim hidhet në procedurë si një e tërë, duke marre per bazë përkatësisht pjesët me sipërfaqe 2.0955 ha, 0.5485 ha, dhe 0.48 ha, të cilat në total përbëjnë sipërfaqen prej 3.124 Ha.

Nga ASHK, Drejtoria Vendore Shkodër, kemi marrë konfirmimin për statusin juridik (Kartelën e Pasurisë së Paluajtshme dhe Fragment të hartës Kadastrale) të pasurisë nr 133/6, Zk nr 2702, ku rezulton se kjo pasuri është me sipërfaqe të përgjithshme prej 160 470 m<sup>2</sup>, e llojit "Ullishte", ndodhur në fshatin Mjedë, Bashkia Vau Dejes.


Bazuar në Udhëzimin nr 1 datë 18.07.2012, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", këto pasuri jepen në përdorim vetëm për zhvillimin e veprimtarive bujqësore, sipas kërkesave të subjektit qiramarrës.

Pas miratimit në Këshillin Bashkiak, dhe shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Prefektit të Qarkut, vazhdon procedura me të gjithë elementet e konkurimit dhe elementet e saj përbërës deri në shpalljen e subjektit fitues dhe lidhjen e kontratës së qirasë, konform kontratës TIP të miratuar, për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara.

Për sa më sipër, ju ftojme për të miratuar këtë Projekt Vendim.

#### Hartuesit e Relacionit

Ndoc Baqli



Armand Filipi



Aldo Gane



**KRYETARI**  
**Mark BABANI**





PLAN RILEVIMI

PERGATITI

**HAMID ÇULIQ**

Liçensa T. 0675/2 Dt. 10.04.2018

Data e pergatitjes: 16.11.2020

- SIPERFAQE

S= 20955 m<sup>2</sup>

ING. TOPOGRAF  
HAMID ÇULIQ  
NR LIÇENSE-T0675/2

A.IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE : 2702

NUMRI I PASURISE : 133/6-S1

VOL \_\_ FAQE \_\_

INDEKSI I HARTES : K-34-64-(245-C),76-(5-A) SHKALLA : 1:2500

ADRESA E PASURISE: Rrethi: SHKODER Q/F: MJEDE

P/G: \_\_ Sh. \_\_ K. \_\_ Ap. \_\_

PRONARI/ET : VALBONA BABA



# PLAN RILEVIMI

## PERGATITI

**HAMID ÇULIQ**

Liçensa T. 0675/2 Dt. 10.04.2018

Data e pergatitjes: 16.11.2020

- SIPERFAQE **S= 4800 m<sup>2</sup>**  
ING. TOPOGRAF  
HAMID ÇULIQ  
NR LIÇENSE-0675/2

## A.IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE : 2702

NUMRI I PASURISE : 133/6-S3

VOL \_\_\_ FAQE \_\_\_

INDEKSI I HARTES : K-34-64-(245-C),76-(5-A) SHKALLA : 1:2500

ADRESA E PASURISE: Rrethi: SHKODER Q/F: MJEDE

P/G: \_\_\_ Sh. \_\_\_ K. \_\_\_ Ap. \_\_\_

PRONARI/ET : VALBONA BABA





# PLAN RILEVIMI

## PERGATITI

**HAMID ÇULIQ**

Liçensa T. 0675/2 Dt. 10.04.2018

Data e përgatitjes: 16.11.2020

- SIPERFAQE

S= 5485 m<sup>2</sup>

ING. TOPOGRAF  
HAMID ÇULIQ

NR. LICENSE 70675/2

## A.IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE : 2702

NUMRI I PASURISE : 133/6-S2

VOL \_\_ FAQE \_\_

INDEKSI I HARTES : K-34-64-(245-C),76-(5-A) SHKALLA : 1:2500

ADRESA E PASURISE: Rrethi: SHKODER Q/F: MJEDE

P/G: \_\_ Sh. \_\_ K. \_\_ Ap. \_\_

PRONARI/ET : VALBONA BABA

